

VENDIM
Nr.194, datë 5.4.2006

**PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUTIT KOMBËTAR TË DIASPORËS,
PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 2 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen dhe funksionimin e Institutit Kombëtar të Diasporës, në varësi të Ministrit të Punëve të Jashtme.

2. Instituti Kombëtar i Diasporës koncepton, bashkërendon dhe mbikëqyr politikat për diasporën.

3. Instituti kryen detyrat e mëposhtme:

- Mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komuniteteve shqiptare në botë, në bashkëpunim me organe të tjera përgjegjëse, si dhe me organizatat joqeveritare.

- Hartimin e politikave për zhvillimin e diasporës shqiptare, të vjetër dhe të re, si dhe hartimin e politikave dhe analizave për çështjet e migracionit shqiptar në vendet, ku ata ndodhen.

- Analizimin e qëndrimeve politike të qeverisë shqiptare, në përgjithësi, dhe perspektivën e politikave aktuale për mbrojtjen e të drejtave, politike dhe sociale, të komuniteteve shqiptare në botë.

- Përcaktimin e programeve për marrëdhëniet dhe bashkëpunimin, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve shqiptare në botë.

- Vlerësimin e strategjive ekzistuese apo atyre që do të miratohen, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Migracionit.

- Kryerjen e studimeve të thelluara ekonomike, sociale, arsimore dhe kulturore për dinamikën dhe zhvillimin e komuniteteve shqiptare në botë.

- Përcaktimin e shteteve, ku duhet të vepohet me përparësi për politikat për diasporën.

- Analizimin e qëndrimeve politike të organeve qeverisëse në vendet e tjera për diasporën dhe emigracionin shqiptar në botë.

- Nxitjen dhe mbështetjen e krijimit të grupeve/shoqatave të veçanta të emigrantëve shqiptarë, në bazë të interesave, profesioneve të përbashkëta apo vendndodhjes gjeografike.

- Hartimin e politikave për vlerësimin e rolit investues të biznesmenëve shqiptarë në botë.

- Krijimin e qendrave kulturore shqiptare në vendet pritëse, ku gjendet një komunitet i madh shqiptar, për të promovuar imazhin e Shqipërisë dhe të emigrantëve shqiptarë, si dhe për të ofruar disa shërbime për komunitetin e shqiptarëve.

- Hartimin e politikave për mësimin e gjuhës amtare nga fëmijët në diasporë, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe me legjislacionin e vendeve, ku ata jetojnë.

- Përgatitjen dhe trajtimin e udhëzimeve për misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Shqipërisë për çështjet e sipërcituara, si dhe për të siguruar ndihmën e komuniteteve shqiptare, për organizimin e vizitave të personaliteteve të larta shtetërore.

- Komunikimin me strukturat/institutet homologe të vendeve të tjera, të cilat trajtojnë çështje të diasporës dhe migracionit.

4. Personeli i Institutit Kombëtar të Diasporës përbëhet nga një staf prej 4 nëpunësish, drejtori i Institutit dhe 3 specialistë, prej të cilëve, të paktën, njëri prej tyre të jetë diplomat. Ky staf merret me funksionimin dhe menaxhimin e plotë të Institutit. Drejtori i Institutit Kombëtar të Diasporës dhe specialistët emërohen në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

5. Pranë këtij Instituti do të veprojë një bord drejtues, me përfaqësues në nivel drejtori të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansave të Barabarta,

Ministritë së Brendshme, Ministritë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministritë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministritë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

6. Bordi drejtues i Institutit Kombëtar të Diasporës të hartojë dhe bashkërendojë politikën për diasporën, duke u bazuar në fushën e kompetencës së ministrave përfaqësues në bord. Bordi drejtues këshillon dhe rekomandon veprime konkrete, për menaxhimin dhe funksionimin e Institutit për realizimin e politikave për diasporën, si dhe përpunon dhe miraton materiale analizuese, kërkimore, shkencore, për politikën për diasporën në botë.

7. Efektet financiare për veprimtarinë e Institutit Kombëtar të Diasporës të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Punëve të Jashtme, si dhe nga donacione të ndryshme nga persona, juridikë dhe fizikë, vendas dhe të huaj, në mbështetje me marrëveshjet përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

8. Vendimi nr.216, datë 14.1.1996 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Institutit të Diasporës Shqiptare”, i ndryshuar, shfuqizohet.

9. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha